



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 646/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.09.2017 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Alen - Co” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim” me objekt “Blerje tuba çeliku me diametër të ndryshëm dhe saraçineska”, me nr. REF-21949-07-24-2017 me fond limit 4,830,193 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 03.08.2017 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.

Ankimues:

“Alen - Co” sh.p.k.
Adresa: Rruga “Nikolla Jorga”, Pallati “Delta 1”, 1001, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë
Adresa: Rruga “5 Maji”, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.07.2017, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim” me objekt “Blerje tuba çeliku me diametër të ndryshëm dhe saraçineska”, me nr. REF-21949-07-24-2017 me fond limit 4,830,193 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 03.08.2017 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 03.08.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 07.08.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultojn si më poshtë vijon:

- | | |
|--------------------------|---|
| 1. “Alen - Co” sh.p.k. | 3,930,110 lekë, (me TVSH), skualifikuar |
| 2. “Ndregjoni” sh.p.k. | 4,371,440 lekë, (me TVSH), skualifikuar |
| 3. “Doka - Roal” sh.p.k. | 4,593,000 lekë, (me TVSH), skualifikuar |

II.4. Në datën 07.08.2017 operatori ekonomik “Alen - Co” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë vijon:

1. *Nuk plotëson pikën 2.2.1 pasi nuk ka paraqitur akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar për vitin 2016.*
2. *Mostra e paraqitur tub celiku nuk është sipas specifikimeve teknike pika 4 tegeli i saldimit SSAW spiral, por gjatësor.*

II.5. Në datën 11.08.2017 operatori ekonomik “Alen - Co” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit. Në ankesë pretendohet si më poshtë vijon:

[...]

-Shoqëria jonë e ka paraqitur akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar për vitin 2016. Ky akt ekspertize gjendet në dokumentin me emrin “Raporti audituesit Alen”. Në këtë dokument do të gjeni dy akt ekspertiza nga eksperti kontabël, një për vitin 2015 dhe një për vitin 2016. Bashkëngjitur do të gjeni një kopje të dokumentit që ne kemi paraqitur pranë jush, fakt i cil dëshmon të kundërtën e asaj që ju pretendoni. Rrjedhimisht kjo arsye skualifikimi nuk qëndron.

-Skualifikimi i kompanisë tonë për shkak se tegeli i saldimit nuk është spiral (ssaë) por i drejtë, është absurd dhe në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Sic mund të shikohet edhe nga kompania prodhuese e tubove, katalogët përkatës dhe certifikatat dhe test raportet, produktet që ne ofrojmë janë sipas specifikimeve teknike që kërkohen në DST. Kompania jonë zotëronte gjendje në magazinën e saj vetëm tubo uji celiku me tegel saldimit të drejtë dhe jo spiral nga kompani përkatëse prodhuese. Është e pamundur për shoqërinë tonë që të sigurojë brenda 10 ditëve mostra të reja tubosh duke lënë pa përmendur faktin se transporti nga Kina në vendin tonë është shumë i gjatë. Gjithsesi duam të theksojmë se mostrat e tubove që ne kemi paraqitur janë sipas specifikimeve teknike që ju keni kërkuar dhe skualifikimi i shoqërisë tonë vetëm për faktin se mostra nuk ishte me tegel saldimit spiral, (fakt i cili nuk ndikon aspak në cilësinë e materialit të tubos së ujit) është diskriminues dhe në kundërshtim me nenin 53 pika 4 të LPP. Kërkojmë nga ana juaj të merrni masa për rishikimin e dokumentacionit teknik dhe në bazë të LPP të bëhet kualifikimi i shoqërisë tonë si fituese.

II.6. Në datën 17.08.2017, nëpërmjet shkresës me nr. 2443/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes, duke e pranuar pretendimin e parë të ankesës dhe refuzuar pretendimin tjetër në lidhje me mostrat.

II.7. Në datën 25.08.2017 operatori ekonomik “Alen - Co” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit nga ana e autoritetit kontraktor si më poshtë vijon:

[...]

Theksojmë edhe njëherë, se tubot që ne ofrojmë janë 100% sipas specifikimeve teknike, I plotësojnë të gjithë standartet e kërkuara, por mosparaqitja e tubove me saldimit spiral por me saldimit gjatësor

për shkak të kohës së shkurtër (10 ditë), nuk ka asnjë ndikim në cilësinë e materialit të tubos. Fakti që autoriteti kontraktor ka deklaruar në përgjigjen e ankesës sonë se materiali i mostrës së paraqitur nuk mund të verifikohet, sepse në raportet e testimi është paraqitur tubi spiral është i pashpjegueshëm dhe i qëllimshëm. Tubi që ne kemi paraqitur si mostër pranë AK-së mund të verifikohet nëse i përmbush specifikimet teknike të kërkuara nga AK-ja ose jo, përse i përket materialit dhe nëse është në përputhje me standartet e tjera të kërkuara në DST. Në rast se ne shpallemi fitues, ne do të lëvrojmë tubo me saldim spiral dhe jo të drejtë, në përputhje me specifikat e kërkuara dhe ashtu sic i kemi paraqitur në broshurat teknike. Fakti që ne kemi paraqitur si mostër tubo me saldim të drejtë dhe jo spiral është pamundësia për ne që ta siguronim këtë mostër – tubo nga kompania jonë prodhuese në Kinë Brenda 10 ditëve. I vetmi ndryshim midis tubos që ne kemi ofruar dhe asaj që kemi paraqitur si mostër është vetëm mënyra e saldimit. Të gjitha specifikimet e tjera mbi standartet që plotëson tuboja dhe materialit të tunos janë të njëjta. Fakti që AK deklaroi se nuk mund të kryejë asnjë lloj verifikimi mbi mostrën se çfarë specifikime teknike përmbush dhe çfarë jo, ngre me shumë dyshime për arsyet e kërimit të mostrave dhe arsyen disi qesharake të skualifikimit të kompanisë tonë. Ne i kemi paraqitur mostrat për të gjithë produktet e tenderite kërkuara sipas DST dhe ne gjuajmë se tegeli i saldimit tek mostrat e tubove është një devijim i vogël, bazuar në nenin 53 pika 4 të LPP, ndaj oferta jonë duhet të klasifikohet e vlefshme. Kërkojmë tju sqarojmë se në krijimin e një tuboje, në varësi se si e njëjta llamarinë celiku me trashësinë e kërkuar përthyer, përcaktohet edhe tegeli i saldimit. Nëse llamarinë përthyer në mënyrë cilindrike, tegeli i saldimit është i drejtë, nëse kjo llamarinë përthyer në mënyrë të pjerrët, tegeli i saldimit është i pjerrët. Pra e njëjta llamarinë me të njëjtat cilësi materiali (në rastin tonë celiku) në varësi sesi përthyer, sjell edhe tegelin e saldimit.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 2569/1 prot., datë 31.08.2017, protokolluar me tonën në datën 06.09.2017 me objekt “Dërgim dokumentash”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Alen - Co” sh.p.k. se “Skualifikimi i kompanisë tonë për shkak se tegeli i saldimit nuk është spiral (SSAW) por i drejtë, është absurd dhe në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat standarte të tenderit, Shtojca 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 10 është përcaktuar:

10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë në vendin dhe orën e përcaktuar për hapjen e ofertave në dokumentat e tenderit, mostra të mallrave objekt prokurimi. Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.

III.1.2. Në dokumentat standarte të tenderit të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik, Shtojca 9, “Specifikimet teknike”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar.

Specifikimet teknike per saraçineskat:

NR	Specifikimet Teknike	Përshkrimi
1	Saraçineskat	DCI
2	Aplikimi Standard	Ujë, ujë i pijshem
3	Temperatura maksimale e punës	60°C
4	Dimensionet e jashtme sipas	EN 558 SERIA 14
5	Lyerja standarde	Me Pudër EPOXY “Fusion bonded”, min. 250 micr; RAL 5015
6	Fllanxhat bashkuese sipas	EN 1092-2
<i>MATERIALET STANDARDE</i>		
7	Trupi dhe pjesët përbërëse	EN-GJS-400-7
8	Pyka	EN-GJS-500-7 e gjitha e rrethuar me EPDM
9	Shpindeli	X20Cr13
10	Timoni	EN-GJS-500-7

➤ **Saraçineskat duhet te jene te matrikuara sipas standartit EN**

Specifikimet teknike per tubat e çelikut:

NR	Specifikimet Teknike	Përshkrimi
1	Tub çeliku i pa izoluar	Në përputhje me standartet ndërkombëtare të prodhimit
2	Aplikimi standard	Ujë, Ujë i Pijshem

3	Temperatura maksimale e punës	60°C
4	Tegeli i saldimit	SSAË spiral
5	Materiali	Çelik për prodhimin e tubave sipas standartit API 5L GR, B
6	Prodhimi i tubave	Standarti API 5L
7	Vetitë mekanike të materialit	Standarti API 5L
8	Shkalla e materialit	Standarti EN 10217
9	Tuba çeliku sipas	Standarti EN 10217

Gjatësia e tubave të furnizuara duhet të jetë 6 ml.

III.1.3. Ndërsa në, Shtojca 10, “*Sasia dhe grafiku i lëvrimit*”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Sasia e mallit që kërkohet:

Sasia e kompleteve te saracineskave

Nr	Përshkrimi	Kompleti
1	Saracineska Dn 100, Pn 10 ÷ 16 bar + 2 fllanxha Dn 100 + bullona + dado + 2 guarnicion Dn 100	1
2	Saracineska Dn 150, Pn 10 ÷ 16 bar + 2 fllanxha Dn 150 + bullona + dado + 2 guarnicion Dn 150	2
3	Saracineska Dn 200, Pn 10 ÷ 16 bar + 2 fllanxha Dn 200 + bullona + dado + 2 guarnicion Dn 200	3
4	Saracineska Dn 250, Pn 10 ÷ 16 bar + 2 fllanxha Dn 250 + bullona + dado + 2 guarnicion Dn 250	3
5	Saracineska Dn 300, Pn 10 ÷ 16 bar + 2 fllanxha Dn 300 + bullona + dado + 2 guarnicion Dn 300	6
6	Saracineska Dn 400, Pn 10 ÷ 16 bar + 2 fllanxha Dn 400 + bullona + dado + 2 guarnicion Dn 400	3

Sasia e tubave te celikut

Nr	Përshkrimi	Diametri nominal Ø (mm)	Trashësia Δ (mm)	Gjatësia L (m)	Pesha Totale (Ton)
1	Tub çeliku	300	5	60	2.35
2	Tub çeliku	400	5	132	6.53
3	Tub çeliku	500	5	168	10.41

Afatet e lëvrimit:

90 (nëntëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

III.1.4. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se në datën 03.08.2017, ditën e hapjes së ofertave, nga autoriteti kontraktor është mbajtur dokumenti *Procesverbal Dorëzim Mostrash*, në të cilën evidentohet informacioni mbi mostrat e paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në procedurën e prokurimit.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.1.6. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.7. Në nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.

Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.8. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.9. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, një ndër parimet kryesore të përzgjedhjes, referuar edhe nenit 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, është mosdiskriminimi dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, operatori ekonomik “Alen - Co” sh.p.k. nuk ka paraqitur mostrat në përputhje me të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, fakt ky i pranuar nga vetë operatori ekonomik referuar ankesës të sjellë prej tij pranë KPP-së dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Konkretisht, e ka pranuar faktin se nuk ka paraqitur mostrën për elementin *Tub çeliku* në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor me arsyetimin se [...] “*Në rast se ne shpallemi fitues, ne do të lëvrojmë tubo me saldim spiral dhe jo të drejtë, në përputhje me specifikat e kërkuara dhe ashtu sic i kemi paraqitur në broshurat teknike. Fakti që ne kemi paraqitur si mostër tubo me saldim të drejtë dhe jo spiral është pamundësia për ne që ta siguronim këtë mostër – tubo nga kompania jonë prodhuese në Kinë brenda 10 ditëve.* [...]”

III.1.11. Referuar dokumentave standarte të tenderit autoriteti kontraktor përcakton detyrimin për paraqitjen e mostrave, një përcaktim detyrues për t'u përmbushur rigorozisht, si nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës gjatë paraqitjes së ofertave të tyre, ashtu edhe nga autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të ofertave. Përcaktimi i një kushti të tillë, detyron autoritetin kontraktor që të pranojë ato mostra të cilat janë konform specifikimeve teknike të përcaktuara në këto dokumenta.

Pra sa më sipër, operatori ekonomik “Adel - Co” sh.p.k. në lidhje me mostrën e paraqitur për *Tub çeliku*, nuk i plotëson specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, fakt ky i pranuar dhe evidentuar edhe nga vetë operatori ekonomik.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alen - Co” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*” me objekt “*Blerje tuba çeliku me diametër të ndryshëm dhe saraçineska*”, me nr. REF-21949-07-24-2017 me fond limit 4,830,193 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 03.08.2017 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1416 Protokolli

Datë 25.08.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha